

VENDIM
Nr. 554, datë 15.7.2026

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI DHE NË PËRDORIM TË BASHKISË
VLORË TË DISA PRONAVE, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE
8605, NJËSIA ADMINISTRATIVE VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2021, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës tek Bashkia Vlorë, të pronave me numrat rendorë 1–2, sipas formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e shërbimeve administrative.

2. Transferimin e së drejtës së përdorimit, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës tek Bashkia Vlorë, të pronës me numër rendor 3, sipas formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e shërbimeve administrative.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet ndryshimi i destinacionit, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të tretët për pronat e përcaktuara në këtë vendim.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vlorë të lidhin marrëveshje, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet për secilin institucion për pronën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, hiqet prona me numër rendor 28 (njëzet e tetë).

6. Ngarkohen Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

